



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2019

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 83, datë 23.12.2019

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Sabina" nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa):

"Sabina" Shpk me NIPT K16619001G, me adresë: Beltojë, Shkodër.

Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Sabina" ka nisur mbi bazën e hetimit administrativ të kryer nga APP për procedurën e prokurimit me objekt: *"Shërbim transporti për punonjësit e IEVP Shkodër për një afat 12 mujor"*, me fond limit 15,000,000 lekë pa Tvsh, të zhvilluar në datë 23.07.2018 nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shkodër.

Gjatë këtij hetimi, është konstatuar se, operatori ekonomik "Sabina" Shpk, në përmbushje të kriterëve për kualifikim, ka keqinformuar dhe ka dorëzuar dokumenta që përmbajnë të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit dhe paraqitjes së dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 83, datë 23.12.2019, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Sabina" për një periudhë 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, pasi është provuar nga konfirmimi i dhënë nga institucioni kompetent për lëshimin e lejeve të drejtimit se, Z. Shemsi Seferi, disponon vetëm kategoritë "B" dhe "C",

dhe jo, kategorinë “D”, sikurse rezulton në dokumentin e paraqitur në tender nga operatori ekonomik “Sabina” Shpk, “Kopje përmbledhëse e dokumentit të lejes së drejtimit”, të lëshuar nga DRSHTRR Shkodër për Z. Shemsi Seferi.

Referuar sa më sipër, mbështetur në provat e administruara, rezulton e provuar se, operatori ekonomik “Sabina” Shpk ndodhet në kushtet e keqinformimit dhe paraqitjes së dokumentave me të dhëna të rreme në procedurën e sipërcituar të prokurimit.